

## **QËNDRIMI I SHTETASVE TË HUAJ NË SHQIPËRI**

Shtetasit e huaj janë lejuar të qëndrojnë në Shqipëri deri në 90-të ditë në bazë të një vize qëndrimi të shkurtër ose pa vizë. Qytetarët e BE-së, SHBA, shtetet fqinje etj nuk kanë nevojë për viza.

Në bazë të Ligjit nr.108/2013 "Për të huajt" (neni 39) dhe VKM nr. 513, datë 13.6.2013 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", shtetasit e huaj mund të aplikojnë pranë Policisë së Shtetit për lloje të ndryshme leje qëndrimi te kategorive të mëposhtëme:

1. Leje qëndrimi si person i punësuar
2. Leje qëndrimi për personat e vetëpunësuar
3. Leje qëndrimi për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit
4. Leje qëndrimi "Kartë blu AL"
5. Leje qëndrimi për shtetasit e huaj kategoria për punësim stinor, të trajnuar pa pagesë, shkëmbime rinore, shërbime vullnetare
6. Leje qëndrimi për kërkim shkencor
7. Leje qëndrimi për studentë dhe nxënës shkolle
8. Leje qëndrimi për të punësuar pranë institucioneve shtetërore humanitare, fetare apo organizatave jofitimprurëse
9. Leje qëndrimi për të punësuar pranë institucioneve shtetërore humanitare, fetare apo organizatave jofitimprurëse të njohura dhe të reregjistruara në organet përgjegjëse të RSH-së
10. Leje e përkohshme qëndrimi e tipit B për "motive të tjera"
11. Leje qëndrimi e përkohshme për bashkim familjar (të tipit B) me një shtetas shqiptar
12. Leje qëndrimi e përkohshme për bashkim familjar (të tipit B) me një shtetas të huaj
13. Leje e përkohshme e qëndrimit e tipit C
14. Leje e përhershme e qëndrimit e tipit C për raste të veçanta
15. Leje qëndrimi për raste humanitare

16. Leje qëndrimi për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore

17. Leje qëndrimi për banorin afatgjatë të një shteti tjetër

Kërkesa për leje qëndrim dhe formulari përkatës i plotësuar, dërgohet pranë Zyrës së Shërbimit për Qytetarët - ZSHQ, njëkohësisht në Njësinë Përgjegjëse Përfundimtare . Njësia përgjegjëse përfundimtare është Drejtoria Lokale për Kufirin dhe Migracionin që ka juridiksion mbi vendin e akomodimit të të huajit. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin shqytron plotësimin e kushteve thelbësore të miratimit dhe harton aktin e miratimit/refuzimit. Në rastin e miratimit plotësohet leje e qëndrimit sipas formatit përkatës e cila dorëzohet me postë zyrtare të brendshme në ZSHQ-në ku është bërë aplikimi.

Afati i përgjithshëm i procedurave për lejeqëndrim variojnë nga 30- 60 ditë.

Për informacion më të detajuar, ju lutemi referojuni faqes zyrtare [www.asp.gov.al](http://www.asp.gov.al)